

VENDIM
Nr. 637, datë 27.10.2021

**PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE
SHOQËROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror (në vijim “Agjencia”), si person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale (në vijim “ministri”).

2. Agjencia financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

3. Agjencia ka për mision sigurimin e cilësisë së produkteve/përfitimeve të kujdesit shëndetësor me të gjitha elementet e tij nga të gjithë ofruesit (publikë ose privatë), me qëllim garantimin e kujdesit shëndetësor, shoqëror e cilësor dhe të bazuar në standarde, nëpërmjet edukimit, certifikimit dhe kontrollit të sigurisë së shërbimeve për strukturat dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe shoqëror.

4. Agjencia ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie:

a) vlerësimin e cilësisë, sigurisë dhe akreditimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor shqiptar, publike dhe private, dhe të institucioneve të kujdesit shoqëror;

b) edukimin në vazhdim të profesionistëve të shëndetësisë dhe profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË AGJENCISË

1. Agjencia ka këto përgjegjësi:

a) të vlerësojë cilësinë dhe të akreditojë institucionet shëndetësore shqiptare, publike dhe private, dhe institucionet e kujdesit shoqëror;

b) të ngrejë mekanizmat për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe mbrojtjes sociale në të gjitha nivelet;

c) të zhvillojë kapacitetet nëpërmjet akreditimit të programeve të certifikuara të edukimit në vazhdim për profesionistët shëndetësorë dhe të kujdesit shoqëror;

ç) të vlerësojë nevojat për formim të vazhdueshëm për kategori të ndryshme të punonjësve të shëndetësisë dhe të kujdesit shoqëror;

d) të menaxhojë projektet dhe programet e miratuara nga ministria në fushën që mbulon agjencia.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË

1. Agjencia e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.

2. Agjencia ka lidhje funksionale bashkëpunimi me institucionet e tjera të kujdesit shëndetësor në varësi të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Agjencia, sipas fushave të përgjegjësisë, kryen këto detyra:

a) kryen vlerësimin e jashtëm të cilësisë për akreditimin e parë dhe periodik të institucioneve të kujdesit shëndetësor e shoqëror për shërbimet që ato ofrojnë;

b) mbështet institucionet shëndetësore dhe shoqërore aplikuese për akreditim lidhur me procesin e vetëvlerësimit dhe vetëpërmirësimit;

c) harton e vë në dispozicion, gjatë fazës së vlerësimit të institucioneve, udhërrëfyesin për vetëvlerësimin e standardeve të akreditimit dhe udhërrëfyesin për vlerësuesit e jashtëm të institucioneve shëndetësore dhe shoqërore;

ç) planifikon, vepron e realizon procesin e vlerësimit dhe harton raportet për vizitat akredituese të realizuara;

d) publikon e boton materialet e informacionet për sigurinë dhe cilësinë e ofrimit të shërbimit shëndetësor;

dh) vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga institucionet e kujdesit shëndetësor dhe shoqëror për akreditim dhe ia paraqet për miratim Bordit të Akreditimit;

e) kontrollon përmbushjen e standardeve bazë të cilësisë të institucioneve të kujdesit shëndetësor pas licencimit;

ë) planifikon, bashkërendon dhe zbaton programe të formimit të vazhdueshëm të profesionistëve të shëndetësisë dhe profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror;

f) bashkërendon punën dhe realizon procesin e akreditimit të ofruesve dhe aktivitetet e edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë dhe profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror, pa përfshirë programet në varësi të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe shkencën dhe strukturave të saj, sipas standardeve, kritereve dhe procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave;

g) organizon mbledhjet e bordeve të edukimit në vazhdim dhe Bordit të Akreditimit në fushën e shëndetësisë dhe të shërbimeve shoqërore dhe i përcjell për vendimmarrje të gjitha çështjet, sipas legjislacionit në fuqi;

gj) zhvillon dhe promovon standardet e cilësisë së edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë dhe profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror përmes ofrimit të asistencës teknike për ofruesit e aktiviteteve të edukimit mjekësor dhe shoqëror të vazhdueshëm për procesin e vlerësimit të nevojave për edukim, planifikimin dhe implementimin e aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm;

h) realizon studime për vlerësimin e nevojave për formim të vazhdueshëm, për kategori të ndryshme të profesionistëve të shëndetësisë dhe profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror;

i) monitoron ofruesit e akredituar dhe aktivitetet e edukimit në vazhdim, të drejtpërdrejta ose në distancë (*e-Learning*), të akredituara, për të garantuar zbatimin e standardeve të cilësisë së edukimit në vazhdim;

j) kryen procedurën e njohjes dhe të regjistrimit të krediteve të edukimit të vazhdueshëm të përfituara nga profesionistët e shëndetësisë dhe profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas standardeve dhe kritereve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave;

k) kryen procesin e certifikimit të profesionistit të shëndetësisë dhe profesionistit të shërbimeve të kujdesit shoqëror;

l) bashkëpunon me institucionet e arsimit të lartë, institucionet akademike, si dhe organizatat e specializuara, shqiptare ose të huaja, për njohjen e programeve të trajnimit;

ll) planifikon, bashkërendon dhe zbaton programe të formimit të vazhdueshëm shëndetësor dhe shoqëror.

4. Agjencia drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e agjencisë dhe përgjigjet përpara ministrit. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë mbështetet në veprimtarinë e tij nga një zëvendës drejtor i Përgjithshëm.

5. Për akreditimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor, pjesë e procesit është dhe rekomandimi nga Bordi i Akreditimit, i cili funksionon sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi

për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.

6. Për edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve shëndetësorë dhe të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, pjesë e procesit janë dhe:

a) Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm për Profesionistët Shëndetësorë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë;

b) Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm për Profesionistët e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë.

7. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin e funksionimit të administratës shtetërore.

8. Rregullorja për mënyrën e funksionimit të Agjencisë miratohet nga ministri, pas propozimit të drejtorit të Përgjithshëm.

9. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm, të zëvendës drejtorit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve të Agjencisë rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të Agjencisë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

10. Agjencia ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

11. Vula e Agjencisë ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të Agjencisë, sipas këtij vendimi, strukturat aktuale vazhdojnë funksionimin e tyre sipas strukturave dhe organikave të miratuara.

2. Numri i punonjësve për Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit dhe Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim riorganizohen në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror.

3. Fondet e miratuara për Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit dhe Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim të mbeten në strukturat aktuale deri më 1 janar 2022.

4. Për nëpunësit e Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit dhe Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil, në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit. Për punonjësit administrativë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

5. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 825, datë 14.5.2008, “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, të punonjësve të shëndetësisë dhe për një shtesë në vendimin nr. 306, datë 27.6.2002, të Këshillit të Ministrave”, dhe nr. 230, datë 15.4.2005, “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore dhe për një shtesë në vendimin nr. 306, datë 27.6.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë”, të ndryshuar”, shfuqizohen.

6. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama